



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.06.2021)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Elbasan, deri në përfundimin e procedimit disiplinor (relator z. Maksim Qoku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 16:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Marinela Osmani, Këshilltare pranë Komisionit.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
7. *Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë.*
8. *{...}, zëvendëskryetare/magjistrate.*
9. *{...}, avokate.*
10. *Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Elbasan, deri në përfundimin e procedimit disiplinor (relator z. Maksim Qoku).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Duke qenë se të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë të pranishëm, fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 7 qershor 2021.

Siç jeni në dijeni, janë përcaktuar për t'i trajtuar sot nga ana e Këshillit 2 çështje.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me detyrë Zëvendëskryetare pra Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, deri në përfundimin e procedimit disiplinor; dhe çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për caktimin e gjyqtarëve për

grykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fillojmë me çështjen e parë. Përpara se të fillojmë, ftojme në sallë të pranishmit, palë në procedim.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes Inspektori i Lartë i Drejtësisë, zoti Artur Metani dhe magjistratja znj. {...} bashkë me përfaqësuesen e saj ligjore.)

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Siç jeni në dijeni, sot nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të merret në shqyrtim kërkesa e bërë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për pezullimin nga detyra të magjistrates, znj. {...}, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, deri në përfundimin e procedimit disiplinor.

Hapim seancën dëgjimore në ngarkim të magjistrates znj. {...}, me detyrë gjyqtare dhe njëkohësisht zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të fillimit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë të procedimit disiplinor ndaj saj, depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 01.06.2021.

Më lejoni t'ju informoj që ILD, me shkresën nr. {...} prot., datë 01.06.2021 i ka kërkuar Këshillit fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare dhe zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ndërsa me shkresën nr. {...} prot, të të njëjtës ditë, ka kërkuar edhe pezullimin nga detyra të magjistrates deri në përfundimin e procedimit disiplinor.

Verifikojmë praninë e palëve. Vërejmë se nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka ardhur vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili është prezent.

Artur Metani: Artur Metani.

Naureda Llagami: Gjithashtu është e pranishme në sallë edhe magjistratja.

{...}: {...}.

Naureda Llagami: Ju bëj me dije se Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 222, datë 02.06.2021 ka vendosur caktimin e anëtarit të Komisionit të Disiplinës, z. Maksim Qoku, në cilësinë e relatorit, për procedimin disiplinor nr.3/2021, vendimi i cili iu është komunikuar palëve të këtij procedimi.

Përpara fillimit të parashtrimeve ju shpjegoj edhe disa rregulla për sa i përket zhvillimit të seancës. Në fillim është Inspektori i Lartë i Drejtësisë i cili do të paraqesë parashtrimet dhe më pas fjala i jepet magjistrates (në rastin konkret {...}) për parashtrimet e saj, duke mos përsëritur përmbajtjen e parashtrimeve, nëse ajo i ka me shkrim.

Pas përfundimit të parashtrimeve, secili nga anëtarët e Këshillit ka të drejtë për të bërë pyetje ndaj secilës palë, ashtu edhe palët ndaj njëra-tjetrës.

Pas përfundimit të pyetjeve, palët do të ftohen për të dhënë kërkesat e tyre përfundimtare, si dhe për të lënë seancën nëse do të vazhdohet me diskutimet dhe vendimmarrjen e procedimit.

Atëherë, pa humbur kohë po fillojmë me parashtrimet e bëra nga z. Metani.

Artur Metani: Faleminderit!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Në vijim të kërkesës nr. {...} prot., datë 01.06.2021 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Vendimit nr. {...} prot., datë 31.05.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistrates {...} me detyrë zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”, Vendimit nr. {...} prot., datë 01.06.2021 “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”, si dhe Raportit të Hetimit Disiplinor, nr. {...} prot., datë 01.06.2021, po ju paraqesim kërkesën për pezullimin nga detyra e magjistrates {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan deri në përfundimin e procedimit disiplinor.

Sipas kërkesave të nenit 140, pika 3, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 152, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve

në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, paraprkisht vlerësohet se në rastin konkret ekzistojnë kushtet ligjore për caktimin ndaj magjistrates {...} të masës provizore të pezullimit nga ushtrim i detyrës deri në përfundimin e procedimit disiplinor, për shkak se vazhdimi i magjistratit në detyrë diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit.

Në rastin konkret, si dhe për sa është cilësuar në Raportin e Hetimit Disiplinor, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e dyshuara të kryerjes së shkeljes disiplinore (natyrën e shkeljes), të cilat kanë të bëjnë me cenimin e standardeve të sjelljes së një magjistrati dhe etikës gjyqësore, e cila duhet të zbatohet për shkak të funksionit, është krijuar një dyshim i arsyeshëm, se vazhdimi në detyrë i magjistrates {...} diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit.

Në mbështetje të nenit 140, pika 3, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur, fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit. Në të njëjtën kohë, në mbështetje të nenit 152, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kur ka dyshim të arsyeshëm se vazhdimi në detyrë i magjistratit dëmton dhe diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit, pas kryerjes së një hetimi paraprak për të verifikuar burimin e informacionit, brenda 3 ditëve që ka marrë dijeni për shkeljen e pretenduar i paraqet Këshilli një raport të arsyetuar bazuar në faktet dhe provat për fillimin e një procedimi disiplinor dhe kërkesën për pezullimin e magjistratit nga detyra.

Në analizë të parashikimeve të nenit 140, pika 3, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 152 të ligjit nr. 96/2016 rezulton se për pezullimin e magjistratit nga ushtrimi i detyrës deri në përfundimin e procedimit disiplinor duhet të plotësohen disa kushte si: (i) Kërkesa duhet të paraqitet në kuadër të zhvillimit të procedimit disiplinor ndaj magjistratit; (ii) Kërkesa duhet të mbështetet në një dyshim të arsyeshëm se vazhdimi i magjistratit në detyrë diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit; (iii) Krijimi i bindjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, se burimi i informacionit është i besueshëm; (iv) Paraqitjen e raportit të arsyetuar për fillimin e një procedimi disiplinor së bashku me kërkesën për pezullimin e magjistratit nga detyra; (v) Të drejtën e magjistratit për të shprehur shpjegimet e tij përpara Këshillit, përpara se ky i

fundit të vendosë për pezullimin e magjistratit nga detyra; (vi) Të drejtën e Këshillit për t'i kërkuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kryerjen e hetimeve të mëtejshme.

Në analizë të plotësimi të këtyre kushteve ligjore në raport me rrethanat e faktit dhe elementët juridikë të këtij procedimi disiplinor rezulton se plotësohen paraprakisht kushtet e parashikuara nga këto dispozita ligjore.

Kërkesa për caktimin e masës provizore, pezullim nga ushtrimi i detyrës të magjistratit, rezulton se është paraqitur në kuadër të zhvillimit të një procedimi disiplinor, i cili po zhvillohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në të njëjtën kohë, në varësi të kompleksitetit të veprimeve hetimore, si dhe provave të administruara në kuadër të këtij procedimi disiplinor rezulton qartë se burimi i informacionit është i besueshëm, në rastin konkret krijohet një dyshim i arsyeshëm se vazhdimi në detyrë i magjistrates {...} diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit, si dhe në raportin për zhvillimin e hetimit disiplinor nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë arsyetuar të gjithë elementët faktik dhe juridikë në lidhje me shkeljet disiplinore dhe përgjegjësinë disiplinore të magjistrates {...}.

Për këtë qëllim, në mbështetje të nenit 132 dhe 152 të Ligjit nr. 96/2016 si dhe nenit 77 dhe 80 të Kodit të Procedurave Administrative në kuadër të këtij hetimi disiplinor janë administruar në cilësinë e provës dokumentacion nga ana e institucioneve si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe të dhëna nga publikimet në median e shkruar dhe atë vizive, të cilat provojnë besueshmërinë e informacionit të administruar.

Gjithashtu, në mbështetje të parashikimeve të parashikimeve të nenit 129, nenit 131 dhe nenit 152, të ligjit nr. 96/2016, magjistrates subjekt hetimi disiplinor i është dhënë mundësia të paraqesë parashtrësia si dhe është marrë në pyetje në ambientet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në datën 01.06.2021.

Masa provizore e pezullimit nga ushtrimi i detyrës deri në përfundimin e procedimit disiplinor të magjistratit, përbën në vetvete një veprim procedural, në kuadër të një procedimi disiplinor të filluar, e cila vendoset nga Këshilli mbi kërkesën e motivuar të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Gjyqtari duhet të ruajë dhe zbatojë standarde të larta të sjelljes dhe duhet t'i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia e gjyqësorit të ruhen. Gjyqtari sillet gjithmonë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin, si dhe sjellja dhe qëndrimi i gjyqtarit duhet të rikonfirmojë besimin e qytetarëve tek integriteti i gjyqësorit. Gjyqtari duhet kujdeset për ruajtjen e integritetit si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën e tij private, me qëllim garantimin e besimit të publikut tek sistemi gjyqësor.

Qëllimi i këtyre parashikimeve ligjore është rikthimi i besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Duke marrë shkak nga rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore nëse magjistrati do të vazhdonte të qëndronte në detyrë rrezikon të dëmtojë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë deri sa procedimi disiplinor të përfundojë.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 152 të ligjit nr. 96/2016, kërkojmë pezullimin nga detyra të magjistrates {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan deri në përfundimin e procedimit disiplinor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Metani!

Fjalën ia jap magjistrates.

Në fakt është prezent edhe përfaqësuesja juaj.

Me prokurë?

{...}: Jo, me deklaram.

Naureda Llagami: Aktin që jeni avokat?

(Fotokopjohet nga administrata dokumenti.)

Naureda Llagami: Për efekt regjistrimi, avokate {...}, me numër licence 7805.

Do flasë përfaqësuesja juaj apo...?

{...}: Dua të flas disa fjalë nga ana ime dhe pastaj mbrojtjen ligjore do ia kaloj përfaqësueses ligjore.

Naureda Llagami: Po! Fjala për ju!

{...}: E nderuar Kryetare!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

I nderuar Inspektor i Lartë i Drejtësisë!

Është shumë e vështirë për mua, si gjyqtare e Republikës së Shqipërisë por edhe si nënë, si grua, të dal përpara jush për të folur për jetën time personale, e bërë publike përmes disa videove të pahetuara se nga dolën. Megjithatë do ta nis me një ndjesë të thellë publike, dhe derisa e vërteta ime të zbardhet, shpresoj shumë që zeri im të dëgjohet, të besohet e vlerësohet në bazë të parimit të proporcionalitetit dhe jo vetëm.

Të nderuar! Kam pritur gjatë të dal para jush apo para cilitdo institucioni tjetër për të dhënë llogari për veprimtarinë time gjatë ushtrimit të detyrës, për vendimmarrjet e mia, e kryesisht për një vendim i cili më ndjek e më përndjek në botën mediatike. Diçka e tillë nuk ka ndodhur deri më sot, ku unë dal para jush dhe po gjykohej për veshjen, për pamjen time apo për shijet muzikore, të cilat nuk kanë ndodhur aspak gjatë ushtrimit të detyrës, të cilat nuk ndikojnë aspak në marrjen e vendimeve nga ana ime, të cilat nuk më ndryshojnë mua aspak në të qenit gjyqtare e denjë, të cilat nuk kanë impaktuar aspak dhe asesi në ushtrimin e detyrës si zëvendëskryetare. Apo në paanshmërinë dhe pavarësinë time si gjyqtare.

Pa ju marrë shumë kohë të nderuar!

Gjyqtarja {...} për të cilën kërkohet pezullim nga detyra ushtron detyrën e magjistratit prej 7 vitesh. Asnjëherë nuk jam konstatuar me shkelje, asnjëherë e denoncuar apo e dyshuar për akte korruptive gjatë vendimmarrjeve të mia. Ashtu siç edhe ju jeni në dijeni të dosjes time personale, çdo hallkë të mësimnxënies e kam mbyllur me rezultate të larta si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Kam përfunduar Kolegjin Turk me mesatare 9.2. Kam ndjekur një kurs në Skoci në Kolegjin “Cardonald College” ku arrita nivelin Highers. Më pas përfundova Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës me

mesatare 9.75. Kam përfunduar studimet Master në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Drejtësisë, dega Shkenca Juridike Civile me mesatare 9.8. Në magistraturë, nga profesorët më në zë të së drejtës, me një vlerësim rigoroz dhe të fortë, bazuar në rezultate objektive, më kanë renditur të dytën, si një nder studentet më të mira në këtë shkollë.

E përmblodha shkurtimisht jetën akademike për t'ju thënë se përballë jush, keni një gjyqtare që ka studiuar ligjet, flet bazuar në ligje dhe shpreson që do të gjykohet bazuar mbi to.

Të nderuar! Gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të profesionit të gjyqtarit kam punuar me përkushtim, me përgjegjshmëri, me devotshmëri madje kam hequr dorë nga jeta private dhe familjare. Jam nënë e dy fëmijëve të mitur, por për shkak të përkushtimit dhe të angazhimit në punë, mungoj çdo ditë në jetën e tyre, aq shumë sa që papritur kuptoj që ata janë rritur pa e shijuar fëmijërinë e tyre. Dita ime e punës nuk mbyllet në orën 16:00 sipas orarit zyrtar të punës. Nga ora 08:00 deri në orën 16:00 zhvilloj proceset gjyqësore mesatarisht 10-15 seanca gjyqësore në ditë si dhe përmbush me përkushtim të gjithë detyrimet në cilësinë e zëvendëskryetares, e cila është një sfidë më vete në një gjykatë si ajo Elbasanit, me një ngarkesë të madhe dhe problematike. Edhe pse aktualisht jam me 50% ngarkesë për shkak të pozicionit të zëvendëskryetares, përsëri vazhdoj të zhvilloj procese gjyqësore me të njëjtin ritëm, respektoj afatet e arsyetimit të vendimeve, marrë pjesë në administrimin e gjykatës. Përmbush me përpikëri të gjithë detyrimet dhe për këtë jam e detyruar të punoj përtej afatit zyrtar. Ndonjëherë ka ndodhur, për hir të së vërtetës, që të kem bërë video apo foto në zyrën time, vetes time, pa prezencën e askujt, për shkak të lodhjes apo stresit të ditës, por kurrsesi për t'i përdorur ato, e aq më pak për t'i publikuar. Absolutisht jo!

Unë jam betuar në dhënien e drejtësisë gjatë vendimmarrjeve të mia dhe asnjë sekondë e jetës sime private nuk ka ndikuar dhe nuk ndikon. Nuk ndikon as në zhvillimin e detyrës si zëvendëskryetare, e aq më tepër si gjyqtare, si zëvendëskryetare për të cilën më votuan vetë kolegët e mi

Gjithë kjo që ka ndodhur vijon të jetë një tmerr personal, moral, psikologjik, shëndetësor dhe familjar për mua, bashkëjetuesin tim, prindërit, vëllain dhe fëmijët e mi të mitur. Pa e menduar dy herë, të gjithë vendosën të më gjykonin dhe të më bënin një

gjq popullor, mediatik dhe moral, duke më dhënë dënimin në “gjyotinë”. Por pres prej jush një trajtim profesional, të pandikuar dhe të paanshëm nga ato që citova më sipër.

Dua të ngre disa pyetje përpara se të shkojmë në vendimmarrje.

A keni ju një rezultat se cila është gjyqtarja {...} si gjyqtare, si profesioniste? Çfarë vendimesh marr unë? Me çfarë ngarkese përballem unë? Sa korrekte jam në sallën e gjykimit? Si i trajtoj palët pjesëmarrëse në proces? Sa e respektoj afatin e dorëzimit të dosjeve? Si e kam menaxhuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në cilësinë e zëvendëskryetares? Çfarë urdhrash dhe vendimesh kam nxjerrë në cilësinë e titullares së këtij institucioni? Si ka ndryshuar rregulli në gjykatë? Si ka ndryshuar mënyra e menaxhimit të punës dhe çështjeve në tërësi? Dhe pyetja më e madhe që ngre lidhur me këtë të fundit është: Kush ka mbetur i pakënaqur nga kjo mënyrë menaxhimi?

Mos vallë bota e krimit nuk arriti të gjej më hapësira për të depërtuar lirisht në gjykatë lidhur me mënyrën e shpërndarjes dhe të trajtimit e administrimit të çështjeve të tyre ?

Vërtet nuk i ka ndodhur askujt që në jetën e tij private të mos ketë rastisur të dëgjojë këngë me përmbajtje të caktuar?

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

I vetmi mëkat për të cilin unë dal sot kokulur përpara jush është filmimi i videove krejtësisht private, të miat, me të cilat nuk kam pasur kurrë qëllimin që të bëhen publike.

Jam përpjekur me mish e me shpirt të jem besnike e ligjit, njeri i ligjit. Kam shkaktuar edhe pakënaqësi.

Më lejoni të pyes sërish se në cilin vend të botës perëndimore ndëshkohet një gjyqtar me pezullim apo shkarkim nga detyra se i janë publikuar video të jetës së tij private duke dëgjuar muzikë apo duke ndjekur tingujt e saj? Pse po gjykohe, rigjykohe dhe ndëshkohe kaq ashpër për një veprim të tillë? A ka një raport të drejtë midis veprimit dhe kundërveprimit?

Shumica e kolegëve gjyqtarë dhe prokurorë kanë rrjete sociale si Facebook, Instagram, Tik-Tok, Twitter, etj. në të cilat publikojnë foto dhe video nga jeta e tyre private, në shtëpi, lokale, makinë, plazh, etj. Pse isha pikërisht unë e goditura? Kë kam shkëlur unë në kallo? Kush ka interes që unë të jem në krye të Gjykatës së Elbasanit apo

gjqtare e kësaj gjykate? Rrugën e kujt po pengoj unë? Kam të drejtë të pyes, mbasi shumë pikëpyetje më lindin njëra pas tjetrës nga kjo situatë e stisur dhe e qëllimshme ndaj meje.

Këto janë pyetje që secili nga ne duhet t'ia bëjë vetes, pasi është e qartë që kjo situatë mori përmasa të tilla sepse ka qenë e qëllimshme dhe e sinkronizuar, për të dëmtuar jo vetëm imazhin tim si femër, si vajzë, si motër, si nënë dhe si grua, por kryesisht për karrierën time profesionale. Të tilla reagime nga media, publiku dhe nga institucionet nuk ka pasur as në ato raste kur gjyqtarët janë ndaluar për kryerjen e një veprë penale, apo më saktë edhe në rastet kur janë ndaluar për kryerjen e veprës penale të korrupsionit, si më e ndjeshmja në radhët tona.

Çfarë veprimi kaq denigrues ishte duke u shfaqur në video, të filmuara në makinë, apo në zyrë pa praninë e askujt? Mos vallë isha duke kryer veprime të pahijshme në drejtim të dosjeve të cilat kam qenë duke i punuar, në drejtim të pelerinës, të sallës së gjyqimit apo të ndonjë elementi tjetër që lidhet drejtpërdrejt me dhënien e drejtësisë dhe me ushtrimin e profesionit? Mos vallë isha duke konsumuar cigare, alkool, drogë apo ndonjë lëndë të ndonjë lloji tjetër? Mos vallë isha duke takuar palë, avokatë, apo duke kryer ndonjë akt korruptiv? - Përgjigja për gjithë këto pyetje është jo.

Nëse unë, {...}, jam druri i shtrembër në stivën e sistemit të drejtësisë, përse asnjëherë nuk më janë gjetur shkelje në dosjet që gjykoj, të cilat i janë nënshtruar kontrolleve të herëpashershme? Jo, nuk janë gjetur sepse jam gjyqtare profesionale dhe nuk cedoj, ndaj u deshën video jashtë orarit zyrtar të punës apo në makinë për të shkatërruar gjithçka timen, të cilën e kam ndërtuar me mund, me forcë, karrierën, familjen, dhe për të më shkatërruar mua si nënë, si grua dhe si femër.

Gjithmonë kam besuar në drejtësinë njerëzore, por mbi të gjitha në drejtësinë e ligjit, mbasi jam vetë një prej besnikeve dhe zbatuesve të Kushtetutës dhe të Ligjit. Jam e bindur dhe shpresëplotë që e vërteta do dalë në dritë. Jam e bindur që një ditë do të provohet që në gjithë këtë situatë u bëra thjesht “kokë turku” e atyre që nëpërmjet meje nuk arritën dot qëllimet e tyre.

Unë e kuptoj dhe e mirëkuptoj presionin e madh që qëndron mbi ju, po ashtu edhe mbi mua, por i kërkoj dhe i lutem Këshillit të Lartë Gjyqësor që të gjykojë gjakftohtë, i

zhveshur nga qëndrimet emocionale që mund të shkaktojë opinionin publik, presioni mediatik e më gjerë në situatën e krijuar. Mos lejoni që ethet e “klikimeve” dhe bota e krimit të fitojë ndaj një gjyqtareje që i ka dhënë jetën, madje ka vendosur punën mbi familjen. Mos lejoni që të sakrifikohem për qëllime të tjera.

Duke shpresuar fort dhe duke kërkuar ndjesë për gjithçka që ka ndodhur deri më sot, shpresoj në dhënin e drejtësisë nga ana juaj.

Me respekt dhe konsideratë, {...}!

Përpos kësaj, në situatën e vështirë në të cilën ndodhem, si dhe për t’i lënë edhe rrugë të hapur hetimit nga ana juaj, kam paraqitur një kërkesë për dorëheqje nga pozicioni i zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me qëllim vijimin normalisht të punës pranë këtij institucioni.

Më lejoni t’i jap fjalën avokates për mbrojtjen time ligjore.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

{...} (Avokate): E nderuar Kryetare!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Po ju paraqesim më poshtë më shkrim objeksionet tona duke parashtruar faktet dhe rrethanat, ligjin përkatës ku jemi mbështetur, analizën dhe arsyetimin ligjor të fakteve, për të arritur në konkluzionin se propozimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk duhet pranuar nga ana e Këshillit.

Sikundër ka relatuar edhe Inspektori pak më parë, me shkresën e datës 01.06.2021 ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Po kështu, po në këtë datë ka vendosur përfundimin e hetimit disiplinor, fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin e masës disiplinore të “Shkarkimit nga detyra”, kjo për shkak të publikimit në media të një video ku tregohet zëvendëskryetarja e gjykatës që del nga një ashensor i gjykatës dhe futet në zyrën e kryetarit, si dhe për dy video të cilat janë jashtë orarit zyrtar në makinë private duke dëgjuar muzikë.

Po kështu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në datën 01.06.2021 ka vendosur t'i kërkojë Këshillit të Lartë Gjyqësor pezullimin nga detyra e magjistratit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan deri në përfundim të hetimit disiplinor.

Përpara se Inspektori i Lartë i Drejtësisë të ndërmerre iniciativën e mësipërme, në të njëjtën datë, magjistrati ka paraqitur parashtrimet e saj, të cilat nuk po i citoj për shkak se ndodhen në përmbajtjen edhe të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Mbështetur në rrethanat në të cilat janë parashtruar deri më tani, më poshtë po analizojmë kuadrin ligjor për të arritur në konkluzionin se kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një kërkesë e cila nuk duhet pranuar për shkak se është e pabazuar në prova dhe në ligj.

Në nenin 4, si dhe në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë deklarohet parimi i shtetit të së drejtës, i cili është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai është një normë e pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues. Ky parim nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike, kjo duke pasur parasysh edhe praktikën konsoliduese të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 4, paragrafi i dytë i Kushtetutës deklarohet shprehimisht se: "Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë". Deklarimi i epërsisë së Kushtetutës, duke e vendosur në majë të piramidës së normave juridike, përbën një aspekt thelbësor të parimit të shtetit të së drejtës dhe ky parim detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normativave kushtetuese. Aktet juridike që dalin nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike me të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe në kuptimin material.

Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës për sa i përket sistemit gjyqësor. Ky parim nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe sipas supremacisë së Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele

të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë dhe një grup normash, duke përfshirë kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre dhe kjo piramidë ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër.

Neni 4/3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton qartë se, dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta e ka të parashikuar ndryshe. Sipas këtij parimi themelor kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Përrjashtimi kushtetues i parashikuar në këtë dispozitë nënkupton se normat kushtetuese mund edhe të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve të caktuara në fusha të ndryshme dhe duke pasur parasysh përputhjen me hierarkinë e normave. Pra, Kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë.

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se nëse ndodhemi përpara një norme ligjore, që nuk mbështetet në parimet dhe rregullimet e specifikuar kushtetuese, por në tejkalime jashtë kushtetuese, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, atëherë ndodhemi përpara cenimit të parimit të hierarkisë së normave. Ky është një qëndrim i cili është i konsoliduar nga Gjykata Kushtetuese në disa çështje të tjera analoge, në të cilat është theksuar se “atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla ...”.

Në nenin 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet shprehimisht: “1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. 2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është

dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. 3. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit. 4. Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite kushtetuese rezulton se Kushtetuta, pa lënë asnjë shteg për mëdyshje, ka parashikuar në mënyrë shteruese si rastet e shkarkimit ashtu dhe rastet e pezullimit të gjyqtarit nga detyra, si garanci për ushtrimin normal të detyrës. Gjithashtu, Kushtetuta i ka diferencuar shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës që lidhen me shkeljet e rënda profesionale dhe etike gjatë ushtrimit të saj, pra “Shkeljet në lidhje me ushtrimin e funksionit” nga “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit”. Nga interpretimi i kundërt (a kontrario ‘a contrario’) i nenit 140 pika 2 të Kushtetutës, rezulton se gjyqtari nuk shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të detyrës së gjyqtarit. Prandaj, në respektim të parimit të shtetit të së drejtës, Këshilli i Lartë Gjyqësor duke zbatuar drejtpërdrejt Kushtetutën, në respektim të parimit të proporcionalitetit, objektivitetit dhe drejtësisë, nuk mundet të aplikojë masën disiplinore ekstreme ndaj gjyqtarit për ndonjë sjellje të magjistratit që ka lidhje me ushtrimin e funksionit (detyrës) së gjyqtarit. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar që “atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla ...”. Pra, Këshilli i Lartë Gjyqësor në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën dhe nuk mund të shkarkojë magjistratin për sjellje që sipas ligjit mund të kategorizohen në “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit”.

Duke iu referuar pikës 1 të nenin 140 të Kushtetutës të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht: “1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.”, rezulton se është parashikuar rezerva ligjore absolute lidhur me rastet që përbëjnë përgjegjësi disiplinore dhe procedurën e tyre. Lidhur me kuptimin e rezervës ligjore, çmoj të evidentoj jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin nr. 19, datë 09.07.2009, ndër

të tjera ka theksuar se: “Në rastin e rezervës ligjore absolute gjykata thekson se është norma kushtetuese ajo që ia rezervon vetëm ligjit rregullimin e një marrëdhënie konkrete, ndërsa në rastin e rezervës ligjore relative, çështja konkrete mund të rregullohet edhe nga aktet nënligjore. Shprehja “vetëm me ligj”, e parashikuar në nenin 11 të Kushtetutës ka kuptimin se në rast se është i nevojshëm kufizimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike, ky vlerësim është në diskrecionin vetëm të ligjvënësit në rastin konkret. Ndodhur në këto kushte, çmojmë se me shprehjen “Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit”, do të thotë që për rastet e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit, duhet të referohemi vetëm ligjit që nxjerrë Parlamenti dhe nuk janë çështje që mund të jenë objekt i akteve nënligjore.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 140 të Kushtetutës të ndryshuar, është miratuar Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim Ligji nr. 96/2016). Në nenin 100 të këtij Ligji nën titullin “Parimet e procedimit disiplinor” parashikohet shprehimisht se: “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme: a) .., cilësoj një nga parimet më kryesore b) parimin e ligjshmërisë, parimin e “mosdënimit pa ligj”; c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova; ç) ... ; d) parimin e prezumimit të pafajësisë; dh) parimin e dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor; e) parimin e proporcionalitetit dhe i pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore;

Gjithashtu, në nenin 101 të Ligjit nr. 96/2016 nën titullin “Shkeljet disiplinore” parashikohet shprehimisht se: “1. Magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur: a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë; b) ...; 2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merret parasysh ndër të tjera c) përvoja dhe

pozicioni i magjistratit në sistem; ç) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi. Rezulton nga kjo dispozitë se sjelljet joetike do të konsiderohen sjellje “gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij”.

Në nenin 102 të këtij Ligji, nën titullin “Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit” parashikohet shprehimisht se: “1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, të cilat janë të renditura në mënyrë shteruese si më poshtë: a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë, e ndër të tjera, nuk po i citoj për efekt kohe dhe janë të relatuara edhe në parashtrimet tona.

Në nenin 103 të Ligjit Nr. 96/ “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit” parashikohet shprehimisht se: “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë, ndër të tjera: dh) raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.”.

Po kështu cilësoj në nenin 115 të po këtij ligji, ku në “Kriteret për caktimin e masës disiplinore” parashikohet shprehimisht se: “1. Në caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe llojit të masës disiplinore, Këshilli merr parasysh disa kritere dhe ndër këto janë: a) llojin dhe rrethanat e shkeljes; b) shkallën e fajësisë dhe motivin; c) pasojat e shkeljes; ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit; d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; dhe të tjera të cilat nuk përbëjnë rëndësi në rastin konkret. 2. Këshilli, kur vendos masën disiplinore: a) duhet të arsyetojë parimin e proporcionalitetit; b) duhet të marrë parasysh çdo rrethanë lehtësuese ose rënduese. 3. Rrethanat lehtësuese, sipas pikës 2, të këtij neni, janë: a) kur magjistrati e kryen shkeljen për herë të parë; b) kur magjistrati ka vepruar nën ndikimin e një pale të tretë, për shkak të besimit ose frikës; c) duke marrë parasysh në tërësi rrethanat e çështjes, shkelja e magjistratit ka pasur ndikim të vogël; ç) kur magjistrati bashkëpunon në hetimin dhe procedimin disiplinor, duke përfshirë dhe rastet kur pranon

shkeljen e kryer ose jep informacione që ndihmojnë në hetimin dhe procedimin disiplinor;... .

Gjithashtu, çmoj të evidentoj jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që ka pasur kompetencë për shqyrtimin e ankimeve ndaj procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe konkretisht vendimin nr. 2, datë 11.04.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku ndër të tjera thuhet se:

“55. Sipas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr.9877/2008, i ndryshuar, në të cilën mbështetet vendimi objekt ankimi, konstatohet se “2. Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë: a)...; b)...; c) shkelja e pajustificuar dhe e përsëritur e dispozitave urdhëruese procedurale, kur këto shkelje kanë pas sjellë ose mund të sillnin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë”. Në interpretim të kësaj dispozite, shprehen Kolegjet e Bashkuara, në harmoni me dispozitat kushtetuese, nenet 128, 140 dhe 147/6 i Kushtetutës, që të ndodhemi përpara rastit të kryerjes së shkeljeve shumë të rënda dhe sjelljeve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit duhet domosdoshmërisht të ekzistojnë në mënyrë kumulative rastet e mëposhtme: (i) shkelja të jetë e pajustificuar dhe e përsëritur e dispozitave urdhëruese procedurale; (ii) shkelja, jo vetëm të jetë e pajustificuar dhe e përsëritur, por ajo njëkohësisht të ketë sjellë ose mund të sillte pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë. Në këndvështrimin juridik, në rastin konkret, nuk mund të qëndrojë si shkak një shkelje që në vetvete përmban arsye objektive justifikimi, qoftë kjo dhe e përsëritur. Gjithashtu, nuk mund të qëndrojë dhe të përbëjë shkak shkarkimi nga detyra e gjyqtarit edhe nëse plotësohet kushti i parë i përcaktuar në ligj, kur nuk vërtetohet ardhja ose mundësia e ardhjes së pasojave për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë. Kolegjet e Bashkuara theksojnë se mungesa e ekzistencës, qoftë edhe vetëm i njërit prej këtyre kushteve bën që të mos ndodhemi përpara shkeljes shumë të rëndë në kuptim të shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 32 në lidhje me pikën 1 të po kësaj dispozite dhe pikës 2 të nenit 31. Po kështu, Kolegjet vlerësojnë se prishja e vendimeve nga një gjykatë më e lartë, nuk është gjë tjetër, veçse pjesë e procesit kushtetues, kjo duke pasur parasysh rastin konkret të këtij vendimi të Kolegjeve të Bashkuara.

Duke u rikthyer në rastin konkret, konstatohet se kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për marrjen e masës disiplinore dhe pezullimin është haptazi e pabazuar në prova dhe në ligj. Kjo për arsye:

Së pari, vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë në shkresën nr. {...}, datë 01.06.2021, kërkesën për shkarkim e mbështet atë në nenin 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 103, shkronja “dh” të Ligjit nr. 96/2016 që bën fjalë për “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit”, por jo për shkelje disiplinore të “gjqtarit gjatë ushtrimit të detyrës”. Ndërkohë që Kushtetuta, pa lënë shteg dhe pa lënë asnjë mëdyshje, ka parashikuar në mënyrë shteruese si rastet e shkarkimit ashtu dhe rastet e pezullimit të gjyqtarit nga detyra, si garanci për ushtrimin normal të detyrës, duke mos e lënë në diskrecion të ligjvënësit të parashikohen motive të ndryshme shkarkimi nga ato që ka parashikuar vetë Kushtetuta. Pra, për sa i përket motive të shkarkimit, ne vlerësojmë që është parashikuar rezerva kushtetuese. Kështu, në nenin 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet shprehimisht: “2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë vetëm ushtrimit të detyrës;...”. Në rastin konkret, vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë konfirmon faktin që magjistrati nuk ka kryer asnjë shkelje profesionale ose etike gjatë ushtrimit të detyrës sikurse parashikohen në mënyrë shteruese në nenin 102 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit”. Ndodhur në këto kushte, çmojmë se në respektim të “parimit të shtetit të së drejtës” si dhe në respektim të “parimit të ligjshmërisë” sanksionuar në nenin 100, pika 1, shkronja “b” të Ligjit Nr. 96/2016, nuk mund të vendoset masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra” dhe për rrjedhojë vendosja e masës së pezullimit, për sjellje që ligji nuk i kualifikon gjatë ushtrimit të detyrës/funksionit të gjyqtarit. Kjo është arsyeja pse Ligji i posaçëm nr.96/2016 në nenin 115, pika 1, shkronja “a” nën titullin “Kriteret për caktimin e masës disiplinore” parashikon shprehimisht se: “1. Në caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe llojit të masës disiplinore, Këshilli merr parasysh: a) llojin dhe rrethanat e shkeljes;...”. Pra, nëse një sjellje kualifikohet si “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit” KLGJ-ja mban parasysh që duhet të hyjnë në kategorinë e sjelljeve që sipas

nenit 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë nuk mund të aplikohet masa ekstreme e “Shkarkimit nga detyra” e gjyqtarit.

Së dyti, Kodi Etikës Gjyqësore në vendimin nr.171 seksioni ç, pika 9 shkronja k dhe c parashikon se “Sipas këtij parimi Gjyqtari ç) nuk lejon që zyra e tij të përdoret për qëllime të tjera të ndryshme që ato lidhen me ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore; k) shfaq vetëpërmbajtje në përdorimin e medias dhe rrjeteve sociale”. Ne mendojmë dhe vlerësojmë se veprimet e magistrates {...} lidhur me regjistrimin e disa videove jashtë orarit zyrtar të punës apo në makinë në jetën time private nuk përbëjnë shkelje disiplinore në kuptim të bazës ligjore të sipërcituar. Mendojmë se zyra e magistratit nuk është përdorur për ndonjë veprimtari tjetër të ndryshme nga ajo e gjyqësorit vetëm për faktin që magistrati ka realizuar disa video të cilat i ka mbajtur në telefonin e saj, për të cilat nuk ka pasur kurrë, në asnjë moment, qëllim që të bëhen publike. Veprimet e magistratit nuk përbëjnë shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij gjatë ushtrimit të detyrës. Gjatë këtyre videove magistrati është paraqitur vetëm në zyrën e saj pa praninë e askujt dhe aq më tepër nuk ka kryer ndonjë veprim që të cenojë integritetin e gjyqësorit, apo të ketë kryer veprime të cilat janë të pahijshme në drejtim të dosjeve të cilat ka qenë duke i punuar, apo në drejtim të pelerinës, të sallës së gjyqit apo me ndonjë element të tjerë që mund të lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e profesionit.

Sipas pikës k) të Kodit të Etikës Gjyqësore gjyqtari shfaq vetëpërmbajtje në përdorimin e medias dhe rrjeteve sociale. Së pari nga kjo kuptohet se gjyqtari nuk e ka të ndaluar të përdorë asnjë rrjet social apo të bëjë publikime në to, por thjesht duhet të tregojë vetëpërmbajtje. Megjithatë duhet të theksojmë faktin që këto video, në asnjë rast nuk janë nxjerrë nga magistratja personalisht dhe as ka qenë qëllimi i magistratit për publikimin e tyre. E pavarësisht kësaj, mediat janë ato të cilat i kanë pasur për qëllim që t’i shpërndajnë, i kanë bërë publike ato, kundrejt vullnetit dhe dëshirës të gjyqtarit, dhe më keq akoma, me dashakeqësi apo thjesht për të qenë në një farë mënyre “ushqim” për disa prej mediave, për disa ditë, për t’u bërë pjesë e përqendruar dhe e shikueshmërisë së tyre (qëllime në të vërtetë të mediave dhe rrjeteve sociale) dhe duke përfituar ndoshta nga pafajësia e fëmijëve të magistratit për përdorimin e këtyre programeve të ndryshme. Vërtetë videot janë zhvilluar në zyrën e shtetit por kurrsesi nuk kam cenuar ndonjë

element të drejtësisë që të mund të cenonjë besimin e publikut tek drejtësia dhe tek aftësia për të dhënë drejtësi në të ardhmen gjyqtari.

Së treti, në nenet 100, pika 1, shkronja “e” dhe 115 pika 2, shkronja “a” e Ligjit Nr. 96/2016 Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet të kishte arsyetuar parimin e proporcionalitetit kur ka kërkuar vendosjen e kësaj mase disiplinore ndaj magjistratit. Në nenin 17 të Kushtetutës, parashikohet shprehimisht se: “1. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. 2. Këto kufizime nuk mund të cenonjë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalonjë kufizimet e parashikuara në Kushtetutë dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kufizimi i të drejtave dhe lirive mund të bëhet vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme: i) Kufizimi duhet të vendoset me ligj. Shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecionin vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Përdorimi i kësaj shprehjeje nuk është i rastit, por është bërë për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit; ii) Kufizimi duhet të bëhet për një interes publik. iii) Duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Ky kusht e imponon ligjvënësin të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në situatën konkrete.

Nëse vërtet do të kishte një shkelje etike, Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet të mbante në konsideratë disa fakte kryesore, të cilat janë; i) magjistrati është në detyrë të re; ii) ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës me rezultate shumë të mira, ku është renditur e dyta në përfundim të studimeve; iii) nuk ka kryer asnjë shkelje disiplinore më parë; iv) janë mbyllur të gjitha rrjetet sociale nga ana e magjistratit që mos të ndodhin më në të ardhmen asnjë mundësi që të publikohet qoftë edhe nga pakujdesia ndonjë video apo foto që lidhet me jetën private. Pra, nga ana e magjistratit janë marrë të gjitha masat aktive për të zhdukur ose pakësuar pasojat që rrjedhin nga publikimi i një videoje në zyrë jashtë orarit zyrtar dhe që nuk ka asnjë lidhje me ushtrimin e detyrës/funksioneve gjyqësore apo administrative; v) gjithashtu, magjistrati është nënë me dy fëmijë të mitur

për t'u rritur dhe të vetmet të ardhura janë pagat. Pra, në rastin e magjistratit, ajo ka një përgjegjësi thelbësore familjare. Kjo e bën magjistratin më tepër të përkushtuar gjatë detyrës së saj si gjyqtare dhe zëvendëskryetare, ku askush nuk ka pasur ndonjë ankesë lidhur me veprimtarinë e saj profesionale. Të gjitha këto fakte nëse do të ishin marrë në konsideratë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në respektim të parimit të proporcionaliteti, objektivitetit dhe drejtësisë, kurrësi nuk mund të kërkonte masën ekstreme për të cilën ai edhe i është drejtuar KLGJ-së, për “Shkarkimin nga detyra” e gjyqtarit. Përkundrazi është haptazi disproporcionale dhe përbën precedent të rrezikshëm, duke e larguar edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor nga misioni i tij për të garantuar pavarësisë e gjyqësorit, ku një nga elementët e tij kryesorë është palëvizshmëria e gjyqtarit nga detyra për shkaqe të paparashikuara nga ligji.

Së katërti, në nenin 152 të Ligjit nr. 96/2016 “Pezullimi në rastin e procedimit disiplinor” parashikohet shprehimisht se: “1. Kur ka dyshim të arsyeshëm se vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen menjëherë një hetim paraprak për të verifikuar besueshmërinë e burimit të informacionit, sipas nenit 124, të këtij ligji, ose ankesës së paraqitur nga subjektet e përcaktuara në nenin 119 të këtij ligji. 2. Këshilli, për rastet e paparashikuara në pikën 1, të këtij neni, ose në nenin 138, të këtij ligji, pezullon magjistratin nga detyra, kur vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit. ...” Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se masa provizore e pezullimit nga detyra jepet vetëm nëse ndodhemi përpara rasteve: i) kur vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor; ii) kur vazhdimi i magjistratit në detyrë pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit. Në rastin konkret, ne vlerësojmë se nuk ndodhemi në asnjë prej kushteve për pezullimin nga detyra. Kjo për faktin se tashmë hetimi disiplinor ka përfunduar, të gjitha provat janë mbledhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe nuk ka asnjë indice që unë mund të ndikojë apo të dëmtojë procedimin disiplinor. Gjithashtu, në kushtet kur nuk ndodhemi përpara rastit të “Shkarkimit nga

detyra”, për arsytet e cituara në paragrafin 11.1 të këtij parashtrimi, ne vlerësojmë që nuk ka asnjë lloj sensi logjik apo juridik të diskutohet diskreditimi i rëndë i figurës dhe pozitës së magjistratit.

Si përfundim, e nderuar zonja Kryetare, të nderuar anëtarë, duke besuar në integritetin moral e profesional të të gjithë trupës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke qenë e bindur që Këshilli nuk do të marrë një vendim në presionin e mediave, duke shkatërruar karrierën profesionale të një gjyqtari të ri në detyrë, por që do ta mbështesë vendimmarrjen e tij vetëm në Kushtetutë e në Ligj, kërkojmë rrëzimin e kërkesës së bërë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si një kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova.

Me respekt dhe konsideratë të lartë, avokate {...}!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Fjalën e do një nga anëtarët, zoti Muharremaj!

Erjon Muharremaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Kisha disa pyetje ndaj gjyqtarës në lidhje me deklaratimet që ka bërë gjatë seancës së marrjes në pyetje në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në datën 01.06.2021. Po i referohem procesverbalit. Po citoj: “Pyetjes së inspektores nëse është kontaktuar gjyqtarja nga media këto ditë? - gjyqtarja pohon që është kontaktuar dje. Pyetjes se çfarë keni thënë? - gjyqtarja i përgjigjet: Nuk kam asnjë ëkaunt/llogari (“account”) në rrjetet sociale, dhe s’i kam bërë unë publike. Kam marrë leje nga KLGJ për të komunikuar me median, për të bërë një reagim zyrtar.”

Pyetja ime është zonja gjyqtare, -mund të na citoni aktin me të cilin keni marrë leje nga KLGJ-ja?

{...}: Për ta sqaruar, se ndoshta edhe mënyra e të shprehurit për shkak të presionit psikologjik në të cilit kam qenë ndaj vetes time, kam komunikuar me shoqe, me kolegët të tjerë, për numër kontakti me dikë në KLGJ thjesht për ta pyetur nëse mund të reagoja me ndonjë qëndrim timin personal apo jo. Përgjigjja që më ka dhënë është që është në dorën tuaj.

Erjon Muharremaj: Pra pohoni që nuk ka një akt të KLGJ-së që ju ka dhënë juve leje?

{...}: Jo, absolutisht jo.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Vijoj me citimin e pyetjes që ju ka bërë inspektori duke thënë që: Me kë keni folur në KLGJ? - shpreheni me një zyrtar të KLGJ-së që lidhet me median. Nuk e mbaj mend emrin. Pyetja vijon: Me administratën? Përgjigjeni: Anëtar i Këshillit që është njëkohësisht edhe përfaqësues për mediat, kryetari i apelit Durrës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor më ka ngarkuar mua Erjon Muharremaj, si anëtar të tijin, për të mbajtur marrëdhëniet me publikun. Unë nuk mbaj mend që të kemi komunikuar së bashku, së pari...

{...}: Jo absolutisht, ndjesë!

Erjon Muharremaj: Së dyti, besoj se e keni të qartë që kryetari i Gjykatës së Apelit Durrës nuk është anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, është gjyqtar për mediat që mbulon juridiksionin e apelit Durrës. Mund të sqaroni këtë deklaratë ju lutem?

{...}: Kjo ishte ideja, për të komunikuar me gjyqtarin e medias që mbulon juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Duke qenë se në dijeninë time ai ishte shkarkuar disa ditë më parë nga procesi i vetting-ut dhe unë nuk dija me kë të komunikoj, thjesht për ta pyetur nëse mund të bëja një reagim apo jo. Kaq është e gjithë situata.

Erjon Muharremaj: Pra konfirmoni që nuk keni kontaktuar me asnjë anëtar të KLGJ-së, as me anëtarin e caktuar për marrëdhëniet me publikun në asnjë moment.

Erjon Muharremaj: Në fakt unë sapo e mora vesh kush është caktuar në këtë pozicion, ndjesë për këtë pjesë! Nuk kam pasur rastin, nuk më është dashur dhe nuk e kam hasur ndonjëherë më parë këtë informacion. Zotohem që nuk kam biseduar absolutisht me asnjërin nga ju në lidhje me këtë reagim, është thjesht personal dhe individual i imi.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Faleminderit, zonja Kryetare!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Kisha një pyetje për magistraten.

Të gjithë jemi të interesuar të dimë a jeni ju që keni publikuar videot?

{...}: Jo!

Ilir Toska: E mohoni kategorikisht këtë gjë?

{...}: Po!

Ilir Toska: Mendoni se është e verifikueshme?

{...}: Nuk e di!

Ilir Toska: Mendoni se hetimi disiplinor është i plotë në këtë aspekt?

{...}: Nuk e di se çfarë veprimi mund të bëhet më?

Nuk është verifikuar, por nuk e di nëse mund të verifikohet.

Ilir Toska: Si e komentoni sjelljen tuaj nga videot që janë publikuar? Kush është vlerësimi juaj? A është dinjitoze ajo sjellje për një gjyqtare apo nuk është dinjitoze?

{...}: Sigurisht që nuk jam krenare, absolutisht jo. Ndihem e turpëruar dhe e fyer në raport me veten në radhë të parë dhe pastaj në raport me të gjithë ata që më rrethojnë. Ndoshta as për qëllime private nuk duhet të kisha bërë veprime të tilla. Kërkoj ndjesë dhe nuk do të përsëritet më kurrë. ...dhe për t'u publikuar as që diskutohet.

Ilir Toska: Kisha edhe për Inspektorin e Lartë disa pyetje.

Të njëjtën gjë do desha të dija edhe nga Inspektori, nëse vlerëson që hetimi disiplinor është i plotë në drejtim të faktit që videot që janë bërë tashmë publike, janë publikuar nga vetë magjistratja apo nga dikush tjetër?

Artur Metani: Po!

Për natyrën e shkeljeve dhe për provat e evidentuara apo dokumentuara, dhe për kërkesën në lidhje me to, mendoj që hetimi është i mjaftueshëm.

Ilir Toska: Çështja e dytë që desha të pyesja zotin Metani është që: Ju keni konsideruar që të filloni hetimin disiplinor për procedimin disiplinor të magjistrates vetëm sa i përket shkeljeve që konsistojnë në akte dhe sjellje diskredituese.

Artur Metani: Po!

Ilir Toska: Nga ana tjetër nuk keni konsideruar që të bëni një hetim të mëtejshëm rreth pasurisë apo figurës së magjistrates.

Artur Metani: Për atë natyrë shkeljeje, mendoj që hetimi është i mjaftueshëm. Nëse Këshilli do vendosë tjetër gjë...

Ilir Toska: Dhe e fundit, e ngriti edhe vetë magjistratja dhe përfaqësuesja, ka një pretendim që performanca e saj profesionale nuk rezulton qartë, pasi evidentohet vetëm për këto pamje për të cilat ka filluar procedimi disiplinor dhe nuk tregohet se çfarë përfaqëson ajo në vetvete, pra të gjithë aktivitetin e saj deri më sot.

Artur Metani: Sepse unë mendoj që të dyja s'kanë lidhje me njëra-tjetrën. Mund të ishte gjyqtare me performancë shumë më të mirë sesa kaq, sesa deklaron vetë magjistrati, por unë mendoj që shkeljet e kryera nga magjistratja janë të asaj natyre që nuk tolerojnë qëndrimin e saj më në detyrë. Mendoj që është tronditur besimi i publikut sepse gjyqtari jo thjesht duhet të japi vendim gjyqësor të drejtë, por duhet të ngjallë besim për vendimin që jep tek qytetarët. Nesër, kjo gjyqtare apo një gjyqtar tjetër me shkelje të etikës, mund të japi vendime shumë të rënda për interesat e qytetarëve dhe duhet të transmetojë besim për seriozitetin dhe argumentimin ligjor që i bën gjyqtari vendimit, edhe nëpërmjet sjelljes së saj edhe nëpërmjet etikës së saj apo të tij. Për këtë arsye mendoj që s'kanë lidhje të dyja.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ndonjë koleg tjetër?

Zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

(Hyrja e fjalës së zonjës Ukperaj nuk dëgjohet.)

...për të sqaruar edhe ne disa rrethana të faktit që lidhen kryesisht me mënyrën e bërjes së videove. Marr shkas nga procesverbali i pyetjeve tuaja gjatë hetimit disiplinor nuk më ka rezultuar e qartë nëse ju keni pasur të instaluar në telefonin tuaj programin Tik-Tok? A e keni pasur të instaluar në telefonin tuaj?

{...}: Nuk e di! Unë kam deklaruar në procesverbal që telefonin tim në shumicën e kohës e përdorin fëmijët dhe ato shkarkojnë programe të ndryshme. Ka një folder të veçantë ku i kam futur këto lojëra dhe as nuk e kam hapur që t'ua shikoj ndonjëherë, por

në momentin që pashë në mëngjes videot në media, kam kontrolluar që nuk kishte as llogari dhe as program të shkarkuar.

Brikena Ukperaj: Llogaria e Tik-Tok nën emrin tuaj “{...}{...}” (nëse jam e saktë) është mbyllur po atë ditë të publikimit të videove. Keni dijeni si ka ndodhur kjo?

{...}: Jo, në çastin që e kam verifikuar në mëngjes, nuk ka qenë.

Brikena Ukperaj: Keni pranuar gjatë hetimit disiplinor që keni qenë në dijeni që djali ka hapur një llogari dhe në atë kohë...

{...}: Pra 1 viti.

Brikena Ukperaj: Me kë telefon e ka hapur këtë llogari djali?

{...}: Mendoj tek telefoni im, rreth para një viti.

Por kam pasur një telefon tjetër dhe me sa duket kur bëhet transferimi i të dhënave, merret automatikisht.

Brikena Ukperaj: Programi.

{...}: Po!

Brikena Ukperaj: Nuk jeni e sigurt nëse ka ekzistuar si program (Tik-Tok) në telefonin tuaj apo jo?

{...}: Jo!

Brikena Ukperaj: Në disa nga videot, përveç lëvizjeve të reklamuar, të cilat ju i keni bërë dhe që e keni pranuar faktin e bërjes së videove, disa prej tyre dalin të

shoqëruara me një tekst muzikor të cilin ju e shoqëroni me lëvizje të buzëve, që tregon që ju ndiqni ritmin e muzikës. Cila ka qenë procedura e bërjes së videos, për ta pasur edhe ne të qartë?

{...}: Në cilin ambient?

Brikena Ukperaj: Në ambientin e zyrës.

{...}: Mendoj duhet të ketë qenë në kompjuter. Nuk më kujtohet mirë, se kanë shumë kohë që janë bërë.

Brikena Ukperaj: Në fakt unë e kam parë videon dhe nuk më ka rezultuar që kompjuteri ka qenë i hapur.

{...}: Çfarë?

Brikena Ukperaj: Kompjuteri nuk ka rezultuar i hapur sepse del edhe ekrani i kompjuterit.

A keni përdorur ndonjëherë program ose aplikacione të programit Tik-Tok për të realizuar një video, pavarësisht faktit të publikimit apo jo?

{...}: Jo, videot i kam realizuar me programin kamera (“Camera”) të thjeshtë.

Brikena Ukperaj: Po muzikën në sfond, qoftë në makinë apo në zyrë?

{...}: Në radio.

Brikena Ukperaj: Në radio?!

Ndërkohë në zyrë, pretendoni që ka qenë me kompjuter.

{...}: Mendoj që ka qenë me kompjuterin e zyrës, por nuk më kujtohet.

Brikena Ukperaj: Në fakt është bërë këqyrja dhe nga foto del që kompjuteri i zyrës ka qenë i fikur.

Edhe një pyetje tjetër kam. Ju jeni në detyrë Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në kuadër të veprimtarisë administrative që ushtroni, keni informacion të plotë lidhur me sigurinë në gjykatë, çka përfshin edhe gjendjen e kamerave të sigurisë në gjykatë. Në dijeninë tuaj, kanë pasur problematikë kamerat e sigurisë që ju keni të instaluar, lidhur me ruajtjen e informacionit?

{...}: Jo! Asnjëherë!

Është specialisti i IT-së që merret me mirëmbajtjen e tyre. Nuk më ka relatuar ndonjëherë ndonjë problematikë.

Brikena Ukperaj: Specialisti i IT-së, në përgjigje dërguar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka deklaruar që informacioni që ruajnë DVD-të e kamerave të sigurisë, ruhet vetëm katër ditë. Ndërkohë që, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave të datës 03.07.2020 ruajtja e të dhënave në kamerat e vëzhgimit lidhur me detektor alarmi dhe kamerave elektronike të lejimit të hyrjes në godinë apo edhe në server, duhet të sigurojnë ruajtje deri në një afat 2-mujor.

{...}: Nuk kam dijeni fare për këtë procedurë. Nuk më ka relatuar asnjëherë ndonjë problematikë.

Brikena Ukperaj: Edhe një pyetje tjetër.

Në fakt ju ka pyetur Inspektori gjatë hetimit disiplinor lidhur me personin, imazhi i të cilit duket në pasqyrën e ashensorit gjatë realizimit të videos në korridoret e gjykatës dhe që pastaj ju futeni në zyrën e kryetarit (reklamohet edhe emri i kryetarit) dhe pastaj vazhdoni prapë, në të njëjtën ditë duket që ka edhe një video tjetër sepse rezultoni me të njëjtën veshje. Lidhur me personin që ju ka bërë atë video, keni ndonjë koment? Sepse

pretendoni që videot janë realizuar jashtë orarit zyrtar. Jashtë orarit zyrtar, kush është një person që mund të realizojë video.

{...}: S'më kujtohet.

Edhe ajo duhet të ketë qenë pas fillimit të detyrës si zëvendëskryetare. Duhet të jenë në atë periudhë. Ka kaluar shumë kohë.

Brikena Ukperaj: Nuk e mbani mend!

Edhe diçka tjetër.

Në videot e publikuara ka një datë të përcaktuar. Ne arrijmë t'i dallojmë, janë të gjitha videot e publikuara në muajin maj. Jeni në dijeni nëse kjo është data e publikimit apo data e realizimit të videos.

{...}: Jo, videot janë të hershme.

Brikena Ukperaj: Pra videot janë të hershme, thjesht hedhja e tyre, shpërndarja e tyre është bërë në muajin maj.

Naureda Llagami: Zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Në fakt janë vijim i pyetjeve që u bënë. Pyetjet janë për magjistraten.

Ju pretendoni që videot janë hedhur aksidentalisht nga fëmija juaj i mitur.

{...}: Ndoshta.

Brunilda Kadi: Ndoshta! Po varianti tjetër cili është?

{...}: E kam çuar në servis dy herë telefonin.

Brunilda Kadi: Që domethënë?

{...}: Që nuk e di nëse mund të jetë hakuar (vjedhur/përgjuar në gjuhën e teknologjisë) ndonjë program.

Brunilda Kadi: Unë personalisht nuk e njoh këtë aplikacionin por kuptohet që ne kemi marrë informacion, të përpiqeshim të kuptonim sa më mirë procesin. Nuk e di, është thënë, ndoshta jo nga specialistë sepse nuk është marrë zyrtarisht informacioni, por sipas disa komenteve, duket që videot janë bërë njëherësh duke u hedhur në Tik-Tok.

{...}: Si janë bërë?

Brunilda Kadi: Domethënë, në momentin që është bërë videoja, hidheshe direkt në aplikacion. Mund të jetë edhe gabim.

Tani pyetja ime qëndron këtu: Ju si mendoni, -se jeni gjyqtare dhe prezumohet që e dini ligjin më mirë nga të gjithë, -nga shkon prezumimi, nga pohimi juaj që videot nuk janë hedhur nga ju apo prezumimi është që videot i keni hedhur ju?

{...}: Që nuk i kam hedhur unë.

Brunilda Kadi: Po pse mendoni që është kështu prezumimi? Telefoni është i juaji, personal. Ju jeni gjyqtare, jeni njeriu më i përgjegjshëm. Duhet të jeni njeriu më i përgjegjshëm i republikës. Si mendoni ju, pse është prezumimi që nuk i keni hedhur ju? Në vijim të pyetjes është: A nuk duhet të ishit ju që duhet të kishit kërkuar një ekspert të verifikonte nëse videot janë hedhur nga ju apo nga dikush tjetër, qoftë edhe nëse është hakuar telefoni dhe nëse është përdorur?

{...}: Në cilën fazë?

Brunilda Kadi: Në cilën të doni.

Në momentin që jeni pyetur nga inspektori, mund ta kishit kërkuar.
Ose, keni ndërmend ta kërkonit këtë, në qoftë se vazhdon hetimi?
Pra të thirret një ekspert që të verifikojë pohimin tuaj. Prandaj ju pyeta si mendoni nga shkon prezumimi, që i keni hedhur vetë apo jua kanë hedhur të tjerët.

{...}: Për mua, nuk i kam hedhur unë.

Brunilda Kadi: Prezumimi sipas jush sepse tani është një fakt dhe duhet të dalë kjo gjë në dritë dhe mbi bazën e asaj mund të ketë ose mund të mos ketë lidhje me hetimin. Nëse do ketë, si mendoni ju, kush duhet të provojë atë që pretendon, ju apo ILD?

{...}: Pala që e provon...

Brunilda Kadi: Pra ju duhet ta provoni?!

Dhe pyetja e dytë e imja është: Edhe në hipotezën që videot janë hedhur aksidentalisht ose në fjalën tuaj dëgjova që mund të jetë edhe e qëllimshme, për arsyet që ju listuat, gjithsesi edhe sikur të provohet që videot janë hedhur në mënyrë të qëllimshme (po marrim rastin më ekstrem) për t'ju dëmtuar ju, ju si mendoni, duke e parë si i tretë ngjarjen, këto videot të cilat u bënë publike, pavarësisht se cila është arsyeja dhe qëllimi, a mendoni se kanë cenuar imazhin e gjyqësorit dhe drejtësisë në Shqipëri? Në sytë e publikut, -jo të atij që keni dëgjuar nëpër media. Ju vetë, sikur të ishit ju konsumatore e drejtësisë, si e mendoni, e ka cenuar këtë imazh?

{...}: Nuk mund të them që është një sjellje me të cilën mund të jesh krenare, - siç thashë edhe më parë, por nuk besoj se veprime të tilla do të ndikonin dhe do të cenonin aftësinë dhe mundësinë time për të dhënë drejtësi, për të qenë e pavarur dhe e paanshme dhe për të ushtruar profesionin në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën.

Brunilda Kadi: Pra, thoni që nuk e kanë cenuar imazhin?

(Ndërhyrje nga një anëtar i cili flet pa mikrofon dhe nuk dëgjohet.)

Brunilda Kadi: Fatmira, për ta korigjuar, i thashë duke lënë mënjane të gjithë atë pretendimin që magjistratja pretendoi që i është....

(Sërish ndërhyrje nga një anëtar i cili flet pa mikrofon dhe nuk dëgjohet.)

Brunilda Kadi: Duke lënë mënjane gjyqin publik që gjyqtarja pretendon se i është bërë nga media dhe ajo ka të gjithë të drejtën e saj të pretendojë. Por them, në sytë e saj, nëse do të ishte një person i tretë dhe do t'i shikonte këto imazhe, a mendon se kjo pamje e ka cenuar imazhin e gjyqësorit dhe drejtësisë? Kjo ishte pyetja.

{...}: Referuar vetes sime, dhe minimalisht ai publik që më njeh në gjykatën ku unë kam ushtruar profesionin, jam e sigurt që njohin edhe të gjithë cilësitë e mia që më karakterizojnë, si gjyqtare, si njeri.

Brunilda Kadi: E fundit. Në lidhje me videot që janë bërë në makinë, janë bërë nga ju?

{...}: Po!

Brunilda Kadi: Ndërkohë që ju drejtoni edhe makinën?

{...}: Po!

Brunilda Kadi: A mendoni që kjo mund të ketë qenë e rrezikshme për jetën tuaj apo duke rrezikuar jetën e të tjerëve duke i dhënë makinës dhe duke bërë video njëkohësisht? Ndërkohë, sipas Kodit Rrugor nuk lejohen as telefonatat, të bëhem me kufje ose mjete të tjera.

{...}: Do preferoja më mirë të kishte qenë e rrezikshme sesa... (nuk dëgjohej fjala e fundit e gjyqtares).

Brunilda Kadi: Faleminderit!

Fatmira Luli: Ndërkohë që ne kemi parë videot që janë bërë në zyrë (dy-tre video janë bërë në zyrë dhe nëpër korridore), si konkludoni ju që këto video s'qenkan bërë gjatë ushtrimit të detyrës? Sepse gjyqtari, për sa kohë është në institucion dhe punon në institucion, aty e ka vendin që ushtron detyrën. Jo vetëm kaq, por gjyqtari edhe pas orarit, në veprimtarinë e tij që lidhet po prapë me përmbushjen e detyrës, ushtron detyrën, dhe kjo nuk lidhet as me orarin zyrtar dhe as me ndonjë veprimtari tjetër.

Pse konkludoni që nuk jeni gjatë ushtrimit të detyrës në kohën që ju keni filmuar video nga zyra juaj, nga korridoret e gjykatës, gjatë kohës që ju keni qenë në gjykatë?

{...}: Sepse ushtrimin e detyrës e kuptoj lidhur ngushtë me ushtrimin e veprimtarisë si gjyqtare. Siç citova edhe më lart, për shkak të ngarkesës, detyrohem të rri përtej orarit zyrtar të punës, për të përmbushur detyrimet në raport me profesionin. Nga ora 08:00 deri në orën 14:00 jam gjithë kohës me pelerinë, me dosje dhe në sallën e gjyqit.

Fatmira Luli: Dhe kjo nuk do të thotë gjë, edhe në momentin që keni qenë duke filmuar videot, keni qenë në detyrë dhe në institucion (jashtë orarit ose brenda orarit zyrtar).

{...}: Jua thashë edhe pak më parë që nuk jam krenare për këtë gjë.

Fatmira Luli: Edhe avokatja juaj e shpjegoi që nuk keni qenë duke ushtruar detyrën dhe detyra, ashtu siç e thatë edhe vetë, bëhet edhe brenda orarit edhe jashtë orarit. Atëherë, pse konkludoni që nuk keni qenë duke ushtruar, për sa kohë keni qenë në zyrë dhe gjatë kohës që keni qenë në zyrë keni ushtruar veprimtarinë edhe si nënkryetare e

gjykatës dhe kryetare e komanduar, edhe si gjyqtare dhe ajo veprimtari nuk është e kufizuar vetëm me pelerinën në sallë gjyqi, por është në zyrë; është në kohën kur arsyetoni; është në kohën kur bëni veprimtari të tjera që lidhen me administrimin e gjykatës ose detyra të tjera që ju ngarkon ligji.

Edhe një pyetje tjetër kam.

Kush e ka mbyllur llogarinë që kishit, që u publikuan këto video? Llogarinë në Tik-Tok, që u publikuan këto video, kush e mbylli menjëherë pas publikimit?

{...}: Në momentin e publikimit kam verifikuar për aplikacionin dhe nuk ishin më.

Fatmira Luli: Nuk e ke mbyllur ti llogarinë?

{...}: Jo!

Fatmira Luli: As nuk e ke hapur ti llogarinë?

{...}: Thashë mbaj mend vitin e kaluar i kam hapur një llogari djalit, i cili luante herë pas here, bënte video të ndryshme, me animacione të ndryshme.

Fatmira Luli: As për ta mbyllur këtë llogari, s'është mbyllur nga telefoni juaj dhe as nuk është hapur nga telefoni juaj?

{...}: Mund të jetë hapur.

Fatmira Luli: Këto video mbajnë data të ndryshme dhe janë publikuar në data të ndryshme, jo në një datë. Mbajnë data të ndryshme. Ju nuk keni konstatuar asnjëherë që këto video janë hedhur edhe më parë dhe kanë qenë periodike, se s'janë në një datë të gjitha.

Mund të ndodhë të bëhet gabim që mund t'i kesh videot në celular dhe gabimisht t'i japësh një komandë dhe të dalin të gjitha përnjëherë, kjo mund të kuptohet. Por kur

publikimi është në data të ndryshme, tregon veprime të përsëritura, konstante, të kryera me dashje kuptohet, për t'i publikuar. Për këtë ke ndonjë shpjegim? Djali jua ka bërë në të tëra rastet?

{...}: S'di të them se kujt t'ia vë fajin dhe kujt t'ia vë gishtin.

Them që ai e përdor pothuajse çdo ditë telefonin tim dhe unë nuk e kam verifikuar sepse as nuk kam kohë të qëndrojë e jo më të merrem me verifikimin e programeve që unë mendoj që i përdorin fëmijët. Për më tepër, siç thashë, dy herë e kam çuar telefonin në servis në periudha të ndryshme dhe nuk e di nëse mund të jetë marrë ndonjë e dhënë personale.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, zoti Metani, pyetje?

Artur Metani: Vetëm një pyetje të lutem zonja gjyqtare.

Sa për sqarim se ndoshta e dëgjova edhe gabim. Ndjesë nëse e transmetoj gabim.

Në fund të parashtresës suaj ju i bëtë thirrje anëtarëve të Këshillit që të mos i nënshtrohen ose të mos bien pre e krimit në vendimmarrjen e tyre, -në qoftë se nuk jam i gabuar. Pyetja ime është: Pse mendoni që anëtarët e Këshillit janë pre e krimit? Për shkak të procedimit që ka nisur Inspektori i Lartë i Drejtësisë?

{...}: Më fal, nuk ju dëgjova.

Artur Metani: Në fund të parashtresës tuaj ju i bëtë thirrje anëtarëve të Këshillit që në vendimmarrjen e tyre të mos i nënshtrohen presionit që vjen nga krimi i organizuar. Kështu e fiksova unë. Nëse e kam fiksuar gabim, -ndjesë! Pyetja ime është: Pse mendoni që anëtarët e Këshillit janë nën presion nga anëtarët e krimit të organizuar? Pse vjen ky presion nga krimi i organizuar tek Këshilli? Nëpërmjet procedurës që ka bërë Inspektori i Lartë i Drejtësisë?

{...}: Jo, e keni kuptuar gabim.

Është në lidhje me mua.

Artur Metani: Ok! Ndjesë!

Marçela Shehu: Kam një pyetje.

Naureda Llagami: Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Ka lidhje në fakt pak me këtë që tha edhe Inspektori, por që kam përshtypjen që unë e kam kuptuar ndryshe.

Gjatë fjalës suaj magjistratë, ju ngritët disa pyetje dhe një nga pyetjet tuaja, ashtu siç unë e kam kuptuar, lidhet me aludimin tuaj që pas këtij gjyqi publik që ju është bërë, mund të fshihen klane të caktuara, të cilët kanë pasur interes në mënyrën apo në menaxhimin e shpërndarjes së çështjeve në gjykatën ku ju ushtroni funksionin e kryetares. Pyetja ime është: A keni pasur ju ndërhyrje apo presione të këtij lloji nga grupe të tilla?

{...}: Jo në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Marçela Shehu: Keni pasur në mënyrë të tërthortë?

{...}: Kërkesa të cilat nuk i kam plotësuar asnjëherë.

Marçela Shehu: Lidhur me këtë shqetësimin tuaj, ju i jeni drejtuar ndonjë organi kompetent apo keni bërë kallëzim?

{...}: Jo, sepse unë supozoj që për sa kohë unë respektoj ligjin, mendoj që unë jam në rregull me veten.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, nëse kolegët nuk kanë pyetje, atëherë unë do i ftoja palët të largohen nga salla për të lejuar Këshillin për të vijuar me vendimmarrjen.

(Dalin nga salla e mbledhjes Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Metani, magjistratja {...} dhe përfaqësuesja e saj ligjore. Vazhdimi i seancës dëgjimore vijon vetëm në prezencë të anëtarëve, deri në komunikimin e vendimmarrjes palëve.)

(Futen në sallën e mbledhjes Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Metani, magjistratja {...} dhe përfaqësuesja e saj ligjore për komunikimin e vendimmarrjes së Këshillit).

Naureda Llagami: Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: 1. Pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me detyrë Zëvendëskryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, deri në përfundim të procedimit disiplinor të iniciuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 2569/12, datë 01.06.2021.

2. T'i kërkohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të kryejë hetime të mëtejshme në drejtim të shkeljes disiplinore të atribuar magjistrates, zonjës {...}.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

4. Një kopje këtij vendimi i njoftohet magjistrates {...} sipas kërkesave të nenit 98, pika 1 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar si dhe bëhet publike në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

(Largohen nga salla e mbledhjes palët.)

* Anëtarët bëjnë një pauzë të shkurtër për të vijuar më pas me shqyrtimin e çështjes së dytë të rendit të ditës nëpërmjet platformës “online”.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.06.2021)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, (relator z. Ilir Toska).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 16:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Valbona Bako, Përgjegjëse pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, (relator z. Ilir Toska).¹

Kjo çështje e rendit të ditës ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Toska.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Fillimisht zoti Toska relaton shkurtimisht se kërkesat që do të trajtohen në mbledhje janë kërkesa nga katër gjykata.

Vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”.

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës** ka paraqitur nevojë për 8 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit (sa kohë 9 gjyqtarë të skemës së delegimit janë caktuar me afat 1-vjeçar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe 1 gjyqtar në një gjykatë të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atë administrativ) dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 8 (tetë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë (çështjet me numër rendor nga 1-7) dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë (çështjen me numër rendor 8).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 8 (tetë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 6 (gjashtë).

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjes nr.1 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë që kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Znj. Enkeleda Dalipi, Z. Sami Ujkashi.

Në shortimin e çështjes nr.4 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Z. Aulon Pashaj.

Në shortimin e çështjes nr.5 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Znj. Enkeleda Dalipi.

Në shortimin e çështjes nr.6 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Z. Sami Ujkashi.

Në shortimin e çështjes nr.8 të përjashtohen nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, si dhe gjyqtari i kësaj gjykate që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Znj. Ornela Naqellari, Z. Ilir Përdeda.

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht të ulët dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e kësaj gjykate, konkretisht: Znj. Enkeleda Dalipi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Aulon Pashaj.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Enkeleda Dalipi.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Sami Ujkashi.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarja Enkeleda Dalipi.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Sami Ujkashi.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Aulon Pashaj.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarja Enkeleda Dalipi.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtarët Artan Hajredinaj (relator), Elsa Ulliri dhe Jak Ndoka (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës**, ka paraqitur nevojë në 1 çështje në lëndë civile.

Kërkesa e Gjykatës së Apelit Durrës është bërë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile sipas Ligjit nr.44/2021, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, datë 14.05.2021, ndërsa ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, pra më datë 29.05.2021.

Në nenin 35 të Kodit të Procedurës Civile, në paragrafin e katërt, sipas shtesave që ka pësuar kjo dispozitë, parashikohet se: “Gjykata e apelit shqyrton çështjen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Gjykata e apelit shqyrton me një gjyqtar të vetëm

ankimet kundër, ndër të tjera edhe ankimet e veçanta kundër vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor”.

Në rastin konkret, çështja civile për të cilën paraqet nevojë Gjykata e Apelit Durrës klasifikohet sipas fjalisë së dytë, të paragrafit të katërt, të nenit 35, të Kodit të Procedurës Civile, çka do të thotë se tashmë kjo çështje në gjykatën e apelit shqyrtohet nga një gjyqtar i vetëm.

Në këto kushte, sa kohë rregullimet procedurale janë menjëherë të zbatueshme, rezulton se nevoja e Gjykatës së Apelit Durrës për caktimin e një gjyqtari, tashmë nuk ekziston, pasi çështja shqyrtohet nga një gjyqtar i vetëm dhe gjykata ka 2 gjyqtarë që nuk kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj.

Ndaj sa më lart, sa i përket kërkesës së Gjykatës së Apelit Durrës, është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenit 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Propozimi i Komisionit në këtë rast është që Këshilli të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Durrës, pikërisht: Kërkesës nr. {...} prot., datë 01.06.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emri i palëve dhe objekti).

(Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime, ndaj propozimi i Komisionit konsiderohet i miratuar.)

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastër**, ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Kërkesat e Gjykatës së Apelit Gjirokastër me numër rendor 1-4 janë bërë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Civile, ndryshime këto që kanë hyrë në fuqi më 29.05.2021.

Edhe në këtë rast katër çështjet (1-4) përfshihen në kategorinë e çështjeve që parashikon neni 35, paragrafi i katërt i Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, pikërisht janë ankimet e veçanta kundër vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kundërshtimin e

veprimeve të përmbaresit gjyqësor, ndërkohë dy prej tyre përfshihen në klasifikimin e bërë në paragrafin e dytë të nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: “Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të gjykatës së apelit vendos një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate.

Nisur nga kjo, nevojat për katër kërkesat e Gjykatës së Apelit Gjirokastër tashmë nuk ekzistojnë më, ndaj referuar të njëjtës bazë ligjore Komisioni i propozon Këshillit, që të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave së Gjykatës së Apelit Gjirokastër si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 31.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emrat e palëve dhe objekti).

2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 31.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emrat e palëve dhe objekti).

3. Kërkesës nr. {...} prot., datë 31.05.2021, për caktimin e dy gjyqtarëve në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emrat e palëve dhe objekti).

4. Kërkesës nr. {...} prot., datë 31.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emrat e palëve dhe objekti).

(Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime, ndaj propozimi i Komisionit konsiderohet i miratuar.)

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastër lidhur me çështjen me numër rendor nr. 5, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë, përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: Znj. Iliba Bezati.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 5, civile, gjyqtarja Margarita Buhali.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë**, ka paraqitur nevojë në 2 çështje në lëndë penale.

Kërkesa e Gjykatës së Apelit Korçë me numër rendor 1 është bërë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale sipas Ligjit nr.41/2021, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.05.2021.

Në nenin 14, të Kodit të Procedurës Penale, pikërisht në pikën 4, parashikohet se: “4. Gjykimet për kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 13 të këtij Kodi, shqyrtohen nga një gjyqtar i vetëm”.

Ndërkohë, në pikën 2, të nenit 13, të Kodit të Procedurës Penale, ndër të tjera parashikohet se gjykohet nga 1 gjyqtar b) ankimi ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e ndjekjes penale.

Nisur nga ky përcaktim ligjor i bërë tashmë, rezulton që nevojat e Gjykatës së Apelit Korça i përket kërkesës me numër rendor 1, tashmë nuk ekzistojnë, sa kohë çështja gjykohet me një gjyqtar të vetëm dhe gjykata ka gjyqtarë të disponueshëm për të gjykuar këtë kërkesë.

Ndaj sa më lart, referuar neneve të sipërpërmendur të Kodit të Procedurës Administrative 90/3 dhe 95, si dhe nenit 97/3 Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Korçë si vijon:

1.Kërkesës nr. {...} prot., datë 31.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: (emri i palës dhe objekti).

(Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime, ndaj propozimi i Komisionit konsiderohet i miratuar.)

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë në lidhje me çështjen nr. rendor 2, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Z. Ridvan Hado.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, që janë në përbërje të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i cili është thirrur në detyrë, konkretisht: Z. {...}; Znj. {...}.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Zegjine Sollaku.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor